

VENDIM
Nr.653, datë 27.9.2006

PËR LEJIMIN E KRYEMINISTRISË TË PËRDORË PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË”, ME SHOQËRINË “RIDGE GLOBAL LLC”, PËR DHËNIE SHËRBIM KONSULENCE, PËR HARTIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR SIGURINË KOMBËTARE, MIRËQEVERISJEN, MBËSHTETJEN PËR ANËTARËSIMIN NË NATO DHE LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT, PASTRIMIT TË PARAVE DHE KRIMINALITETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 3 e 5 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të neneve 2 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Kryeministrit, që, për fondin limit prej 46 608 000 (dyzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e tetë mijë) lekësh, të përdorë procedurën “prokurim i drejtpërdrejtë”, me shoqërinë “Ridge Global LLC”, për dhënie shërbim konsulence, për hartimin e strategjisë kombëtare për sigurinë kombëtare, mirëqeverisjen, mbështetjen për anëtarësimin në NATO dhe luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe kriminalitetit, sipas termave të referencës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Kryeministrit, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet fondi prej 15 536 000 (pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe pjesa e mbetur të parashikohet në buxhetin e vitit 2007.

4. Shpenzimet e udhëtimit nga/dhe në Republikën e Shqipërisë të konsulentëve të huaj, të përzgjedhur nga shoqëria konsulente, të përballohen nga buxheti i Kryeministrit, miratuar për vitin 2006.

5. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha